



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:173572
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05380022

C.nr.511/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Shkurte kadriu, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit H B nga fshati M, Komuna e F, të cilin me autorizim e përfaqëson Ramiz Shehu avokat nga Ferizaji, kundër të paditurve A L dhe K G-L nga F, të cilët me autorizim i përfaqëson Nazmije Ibrahimimi avokate nga Ferizaji, me objekt kontesti lirimin e pronës, pas mbajtjes së seancës gjyqësore, më datë 14.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet e tërhequr padia e paditësit H B nga fshati M, Komuna e F, kundër të paditurve A L dhe K G-L nga F, me objekt kontesti lirimin e pronës.

A r s y e t i m

Paditësi H B nga fshati M, Komuna e F, përmes të autorizuarit të tij më datë 09.12.2020, ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurve A L dhe K G-L nga F, me objekt kontesti lirimin e pronës.

Gjykata me datë 14.02.2024, ka caktuar seancën përgaditore lidhur me këtë çështje kontestimore.

Në seancën për shqyrtimin përgatitor, nuk ka prezantuar paditësi si dhe përfaqësuesi i tij me autorizim avokat Ramiz Shehu nga Ferizaji, ku gjykata konstaton se nga fletëkthesa për dorëzim personal i njëjti ftesën për seancë e ka pranuar me datë 17.01.2024, por mungesën nuk e ka arsyetuar me ndonjë parashtrësë me të cilën do të kërkonte shtyerjen e kësaj seance, po ashtu në këtë seancë kanë munguar edhe të paditurit si dhe përfaqësuesja e tyre me autorizim avokate Nazmije Ibrahimimi, ku gjykata konstaton se nga fletëkthesa për dorëzim personal e njëjta ftesën për seancë e ka pranuar me datë 16.01.2024, por mungesën nuk e ka arsyetuar me ndonjë parashtrësë me të cilën do të kërkonte shtyerjen e kësaj seance.

Andaj, duke pas parasysh faktin se palët ndërgjyqëse nuk kanë prezantuar për seancën e shënuar më lartë edhe pse kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën nuk e

kanë arsyetuar me ndonjë parashtrësë me të cilën do të kërkonin shtyrjen e seancës, gjykata ka vendosur që padinë e paditësit ta konsideroj të tërhequr,

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 409 parag.1 dhe 142 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.511/2021, datë 14.02.2024

Gjyqtarja,
Floriqe Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas pranimit të të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate.